



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

NJOFTIM PËR SHTYP

Shërbimi Informativ i Shtetit përmbledh punën e vitit 2020 në Raportin e tretë Publik

Tiranë, 23 gusht 2021

Shërbimi Informativ i Shtetit publikoi sot për të tretin vit me radhë Raportin Publik.

Raporti vjetor, botimi i të cilit po shndërrohet tashmë në traditë, e njeh publikun me përmbledhjen e disa prej veprimtarive më të rëndësishme të SHISH-it gjatë vitit 2020, në funksion të sigurisë kombëtare, edhe në kushtet e krijuara nga pandemia “Covid-19”.

Me publikimin e Raportit Nr.3, SHISH-i ka vendosur mbi baza të shëndosha synimin për të përmirësuar më tej bashkëpunimin me publikun, të drejtën e tij për t’u informuar dhe transparencën, por duke ruajtur parimet e fshehtësisë së formave e metodave të punës së tij, në zbatim të ligjit dhe të respektimit të të drejtave të njeriut.

Me rastin e publikimit të Raportit Publik 2020, Drejtori i SHISH-it, z. Helidon Bendo, thekson:

“Gjatë 2020-ës, duke u mbështetur te prioritetet e veprimtarisë vjetore, SHISH-i është angazhuar në përmbushjen e detyrave e misionit të tij, i përqendruar në drejtime të tilla si: kërcënimet që vijnë nga veprimtari jo-miqësore informative e tensione të ndryshme gjeopolitike, parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar në përgjithësi dhe narkotrafikut në veçanti, krimeve në ekonomi, korrupsionit e kërcënimeve kibernetike.

SHISH-i është kundërpërgjigjur, duke shtuar fokusin e punës, kapacitetet operative dhe informative, me plane konkrete për t’i parandaluar dhe goditur këto dukuri, në bashkëpunim me agjencitë ligjzbatuese dhe shërbimet e agjencitë informative partnere”.

Drejtori Bendo vlerësoi punën e angazhimin e të gjithë punonjësve të Shërbimit, gjatë një viti të vështirë, ndërsa nënvizoi vullnetin për të thelluar e zgjeruar marrëdhëniet e institucionit me publikun e median.

Raporti Publik 2020 mund të shkarkohet i plotë në formatin PDF, në variantin shqip dhe anglisht, në faqen www.shish.gov.al.

KABINETI I DREJTORIT TË SHISH